



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:154197

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06098459

P.nr.355/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale ndaj të pandehurit T. A. nga fsh. K. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4214/23 të dt.10.07.2023, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 28.08.2024, në prani të prokurores se shtetit Nebahate Salihi, dhe të pandehurit dhe mbrojtëses av. Teuta Zhinipotoku nga Prishtina, në të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

T. A., nga i ati Xh. dhe e ëma Z., e gjinisë I., i lindur më ... në L., me vendbanim në fsh. K. K. L., i gjendjes mesme ekonomike, i pa punë, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Më datën 03.11.2022, rreth orës 14:40 në rrugën "L. e P." në L., i pandehuri T. A., pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit Marihuanë me peshë prej 0.09 gram, në atë mënyrë që gjatë patrollimit, zyrtarët policor kanë ndaluar të pandehurin dhe gjatë kontrollit trupor, i kanë gjetur substancën e tillë narkotike, të cilën më pas ia kanë sekuestruar,

- Me këtë e ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 269 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 200-€ (dyqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënim me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 30-€, dhe shumën prej 20-€ në Fondin e Viktimave të kimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

URDHËROHET konfiskimi i substances narkotike e llojit Marihuanë, me peshë neto 0.09 gramë e cila është sekuestruar nga ana e Policisë me datën 03.11.2022 dhe urdhërohet shkatërrimi i saj.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4214/23 të dt.10.07.2023, e ka akuzuar të pandehurin T. A. nga fsh. K. K. L., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri në seancën për shqyrtim fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është i penduar për veprën e kryer, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit sjellje të tilla, është i gjendjes jo te mirë ekonomike, i moshës së re, i pa punë, i ka propozuar gjykatës që të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurorja e shteti në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së si dhe i ka propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe të njejtit t'i shqiptoj një dënim konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësja e të pandehurit av. Teuta Zhinipotoku në seancën për shqyrtim fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në konsultim me të dhe pasi i'a ka shpjeguar benefitet e pranimin të fajësisë i njejtë e ka pranuar. Gjykatës i ka propozuar që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe gjatë matjes së dënimit i ka propozuar gjykatës që t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat që i përmendi vet i pandehuri.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, dhunës dhe premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale faktin është i moshës së re dhe ka gjasa që në të ardhmen të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërit sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa në mungesë rrethanave rënduese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të vepes penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 të KPPRK-së, vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të nenit 36 par. 3 pika 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskim u bazua në nenin 269 par.3 të KPRK-së, pasi sendi i konfiskuar është send qenësisht i rrezikshëm dhe i paligjshëm andaj bazuar në dispozitën e lartpërmendur sendi u konfiskua dhe u urdhërua shkatërrimi i saj.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.355/23 dt.28.08.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Vesa Bajrami

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.